



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 22 datë 06/03/1995

**MBI
TRANSFERIMIN E TREGUT TE KEMBIMIT TE VALUTES SE HUAJ
NGA SHESHI PERPARA TEATRIT TE KUKULLAVE.**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Seksioni i Kulturës “Mbi transferimin e tregut të këmbimit të valutës së huaj nga sheshi përpara Teatrit të Kukullave”, në mbështetje të nenit.14, të Ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”

V E N D O S I

1. Të transferohet tregu i këmbimit të valutës së huaj nga sheshi përpara Teatrit të Kukullave në anën tjetër të Bankës pranë PTT.
2. Të hiqet stacioni i autobuzit si dhe të gjitha tezgat pranë teatrit.
3. Të mos lejohen të parkojnë dhe të qarkullojnë automjetet në trotuarin dhe në rrugën përpara teatrit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Seksioni i Kulturës, ai i Komunikacionit, i Tregëtisë si dhe Komisariatet e Policisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA